



Primeshje / Dostava Primesha / Predato Received / Delivery	14.11.2022	2	viti god year
Organ / Agjenci Organ / Jednica Org. / Unit	SKPM/SLK	7072/2022	114
№ Prof. Br. Prof. Prof. No.			
Shtesa Prilog Appendix			
Sasia Kolicina Quantity			



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.840/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.840/2022 të datës 30.09.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër Përgjigjes me numër 01-1-120/04-0087580-2/22 të datës 26.09.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës, në çështjen juridike-administrative "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa me numër A.nr.840/2022 e datës 30.09.2022 e parashtruar nga ankuesi e bazuar.
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore-administrative për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti gjashtë (6) në koeficient tetë (8).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me datë 30.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5870/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes me numër 01-1-120/04-0087580-2/22 të datës 26.09.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës, për shkak

të shkeljeve të dispozitave materiale, dispozitave procedurale dhe diskriminimit në shpërblim të pagës konform kategorisë, nivelit profesional dhe gradës të përfshira në Akt Emërimit me numër protokollit 01-112/01-0001562/2019 të datës 08.01.2019 dhe Plotësim Ndryshimit të Akt Emërimit me numër të protokollit 01-112/02-0028822-3/20 të datës 23.06.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datë 06.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa, Këshilli me datë 11.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:

Ankesën me numër të protokollit 5784/2022 të datës 30.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Pune të ankuesit të datës 23.12.2021; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Pune të ankuesit të datës 25.01.2021; Konfirmim për disponueshme e mjeteve financiare të datës 02.08.2022; Formularin e shpenzimeve të departamentit, divizionit ose sektorit të datës 08.08.2022; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Përgjigjen në kërkesë me numër reference: 01-120/04-0087580-2/22 të datës 26.09.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; Konkursin për pozitën Zyrtar Ligjor 2, me numër reference:RN00009125 të datës 27.05.2022 Konkursin për pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike me numër reference: RN00009989 të datës 23.09.2022; Konkursin për pozitën Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit me numër reference:RN00009981 të datës 23.09.2022; Listën e pagave për muajin gusht dhe shtator 2022; Kërkesën 09.08.2022 me numër reference: 01-120/04-0078844/22 për harmonizimin e koeficientit të pagës; Ndryshim dhe Plotësimin e Akt Emërimit me numër të protokollit 01-112/02-0028822-3/20 të datës 23.06.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 6067/2022 të datës 11.10.2022; Fletedorëzimin e datës 27.09.2022 me numër reference:01-120/04-0087580-3/22; Kërkesën e datës 26.09.2022 me numër reference: 01-120/04-0087580-2/22 të parashtruar nga ankuesi në Zyrën e Personelit; Listën e pagave të datës 01.09.2022 deri me datën 30.09.2022; Listën e pagave të datës 01.08.2022 deri me datën 31.08.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike" të datës 21.09.2022; E-malin me numër të protokollit 7005/2022 të datës 10.11.2022 të drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-malin e datës 09.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës drejtuar zyrtares në Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publik; E-malin e datës 07.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës drejtuar në Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar, **SEPSE**:

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji gjen së ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, gjegjësisht i njëjti sipas Aktit-Ndryshim dhe Plotësim të Akt Emërimit me



numër të protokollit 01-112/02-0028822-3/20 të datës 23.06.2020 mbanë pozitën e punës "Zyrtar i Lart Ligjor" pranë Drejtorisë së Inspeksionit.

Me tej nga provat e çështjes rrjedhë së ankuesi më datë 26.09.2022 parashtron kërkesë të Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, për harmonizim (ngritje) të koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8). Ndërsa ky i fundit, përmes shkresës me numër reference 01-120/04-0087580-2/22 të datës 26.09.2022 ka refuzuar kërkesën e ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit me arsyetimin se Komuna nuk ka ndonjë Zyrtar të Lartë, i klasifikuar si profesional 1, duke përfshirë dhe inspektorët komunal që kanë koeficient tetë (8).

I pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, ankuesi me datë 30.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale, dispozitave procedurale dhe diskriminimit në shpërblim të pagës konform kategorisë, niveli profesional dhe gradës të përfshira në Akt Emërimit me numër protokollit 01-112/01-0001562/2019 të datës 08.01.2019 dhe Plotësim Ndryshim të Akt Emërimit më numër të protokollit 01-112/02-0028822-3/20 të datës 23.06.2020. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj Kryetarin e Komunës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizim (ngritje) të koeficientit të pagës së ankuesit në pozitën e punës Zyrtar i Lart Ligjor nga koeficienti gjashtë (6) në koeficient tetë (8).

Kolegji i Këshilli duke u bazuar në dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më datë 07.11.2022 i është drejtuar me shkresë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë dhe funksionarëve publikë, duke kërkuar informacione në lidhje me koeficientin e pagës për titullin e punës Zyrtar i Lart Ligjore. Ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në përgjigje të datës 10.11.2022, ka informuar Këshillin së duke bazuar në Rregulloren (QRK) nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogut të Vendeve të Punës është përcaktuar, si vijon: pozita Zyrtar i Lartë ligjor, klasa: profesional 1, koeficienti i pagës është 8, ndërsa pozita/titulli i vendit të punës, duhet të jetë i barasvlershëm, i unifikuar, për shkak të detyrave dhe përgjegjësiive, si dhe në pajtim me ligjin e buxhetit vjetor për organizatën përkatëse buxhetore.

Andaj, duke marr parasysh konstatimin se ankuesi mban pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor dhe duke qenë së me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur çështjen e pagave të zyrtarëve publikë për këtë pozitë pune është përcaktuar koeficienti tetë (8) i pagës, Kolegji në kuptim të dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, konstaton se ankuesit i njihet e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës me titullin e punës.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit mos realizmi i pagës së njëjtë për punë të njëjtë paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të ankuesit ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: "Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve në kuptim të së drejtës së pagës është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..." Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm. Kështu që bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit konstaton së në këtë çështje administrative janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e tërësishëm të ankesës së ankuesit duke i dhënë të drejtë ankuesit për rregullimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6), në tetë (8), për pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e Nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.840/2022

Ilire Mehmeti-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.